



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:124644

Datë: 09.09.2024

Numri i dokumentit: 06162830

KA.nr.662/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Al Petrol” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga E.F., kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Fushë Kosovë, për shkak të anulimit të vendimit AUV.Ref.04/2-519/2021 i datës 07.06.2021, pas shqyrtimit kryesor publik me datë 04.09.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, E.F. dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me datë 09.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET në tërësi e bazuar** kërkesëpadia e paditësit “Al Petrol” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Fushë Kosovë.
- II. **ANULOHET** Vendimi AUV.Ref.04/2-519/2021 i datës 07.06.2021 si i kundërligjshëm.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 16.06.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, paditësit “Al Petrol” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga E.F., kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Fushë Kosovë, ka parashtruar padi për shkak të anulimit të vendimit AUV.Ref.04/2-519/2021 i datës 07.06.2021, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë vendimin e kundërshtuar si të kundërligjshëm dhe të obligohet e paditura të i paguaj shpenzimet e procedurës administrative. Lënda është evidentuar me nr. A.1348/21.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.662/22.
3. Seanca e shqyrtimit kryesor publik u mbajt me datë 04.09.2024, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit, përfaqësuar nga E.F. me autorizim nr.LRP 3888/2023 të datës 05.04.2023 dhe konform nenit 41 të LKA në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, përfaqësuar nga Avokate Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, me autorizim të datës 26.08.2024. Gjykata në bazë të shkresave të lëndës konstaton se e paditura për mbajtjen e datës së shtyerjes të seancës ka qenë e njoftuar me procesverbal të datës 26.08.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, ka deklaruar se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK) Inspektori Sanitar me datë 25.05.2021 në ora 22:24 pas inspektimit të subjektit “Al-Petrol” SH.P.K ka shqiptuar gjobën në vlerë prej 500 €, me arsyetim se personi juridik “Al-Petrol” SH.P.K nuk ka respektuar Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, Ligji nr. 07/L-006 dhe vendimin qeveritar nr. 01/07 i datës 18.04.2021.
5. Paditësi e kundërshton vendimin e Inspektoratit Sanitar me pretendimin se nuk janë zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe që vendimi i atakuar është i kundërligjshëm prandaj mbi bazën e këtyre pretendimeve pala paditëse ka ushtruar ankesë me nr.3905 me datë 27.05.2021.

Ndërsa e paditura, me Vendim AUV.Ref.04/2-519/2021 me datë 07.06.2021, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka lënë në fuqi gjobën e shqiptuar nr.017276/IS të datës 25.05.2021.

6. Pala paditëse konsideron se Vendimi i Komisionit për shqyrtim të ankesave AUV.Ref.04/2-519/2021 i datës 07.06.2021, është i kundërligjshëm sepse përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore të nenit 47 paragrafi 1, pika 1.1 ku theksohet se: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes”* dhe pika 1.2 e të njëjtit nen, që thekson: *“pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit”*.
7. Pala paditëse konsideron se aplikim tjetër i gabuar i dispozitave ligjore është se vendimi i kontestuar është marrur në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 i LPPA, paragrafi 1, pika 1.3, ku theksohet se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave”*; pika 1.4 e të njëjtit nen: *“bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret”*; pika 1.5: *“shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve”* dhe paragrafi 2 i të njëjtit nen që thekson: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Këtë deklaram paditësi e bazon në faktin se arsyetimi i vendimit të kundërshtuar nuk përmban shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, faktin se cili vendim i Qeverisë nuk është respektuar as numri dhe data e vendimit që sipas paditësit rezulton që konstatimi në vendimin kontestues të jetë arbitrar sepse periudha e validitetit të lejes së punës EDI nga sistemi i ATK, nuk është konstatuar si veprim i kundërligjshëm as në Fletë përmbajtjen e Kundërvajtjes nr.017276/IS i datës 25.05.2021.
8. Pala paditëse konsideron se aplikim tjetër i gabuar i dispozitave ligjore është se e paditura nuk i ka vërtetuar pretendimet ankimore të paditëses lidhur me kohën e inspektimit sepse inspektimi kishte ndodhur në ora 22:24 kur nuk ka qenë koha e

kufizuar e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve duke u mbështetur në nenin 12, paragrafi 12.3 i Vendimit të Qeverisë nr.01/07 i datës 18.04.2021 ku theksohet se: *“Kufizohet qarkullimi i qytetarëve nga ora 22:30 deri ne 05:00, përvec Operatorëve Ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zingjirit të furnizimit (përfshire transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të vecantë nga sistemi EDI i Administrates Tatimore të Kosovës”*, ku nuk përcaktohet afati kohor i paisjes me leje apo validitetin e saj.

9. Pala paditëse konsideron se konstatim i kundërligjshëm nga ana e të paditurës është refuzimi i ankesës së paditësit ku kanë konstatuar se paditësi nuk ka leje të re nga EDI sistemi i ATK duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë nr.01/07 të datës 18.04.2021, sepse paditësi konsideron se ky vendim nuk e përcakton kohën e validitetit të lejes EDI dhe as nuk përcakton që kjo leje të merret cdo muaj sa herë që Qeveria merr Vendime të reja. Prandaj konsideron se vendimi kontestues është i kundërligjshëm sepse është shkelur dispozita 52, paragrafi 1, pika 1.1 i LPA, paragrafi 2 i nenit 4 të këtij Ligji, pika 1.3 dhe pika 1.4 të Ligjit të Procedurës Administrative.

Kundërshtimet e të paditurës

10. Bazuar në shkresat e lëndës, pala paditëse Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Avokate Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, me autorizim të datës 26.08.2024, në kopje të Padisë me provat e bashkangjitura e ka pranuar në seancë të shqyrtimit kryesor me datë 26.08.2024. Gjykata nuk ka pranuar Përgjigje në Padi nga e paditura.

Provat e administruara

1. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me numër protokolli 4163 i datës 07.06.2021 i nxjerrë nga e paditura; ankesë kundër Fletëpërmbytjes për kundërvajtje me numër serik 017276/IS i datës 25.05.2021 e parashtruar nga paditësi me datë 27.05.2021; Fletë përmbytje për kundërvajtje me numër serik 017276/IS i datës 25.05.2021; Vendim me numër protokolli 3849 me datë 25.05.2021; Vendim i Qeverisë me numër 01/07 me datë 18.04.2021 dhe Vendim i Qeverisë me numër 01/05 me datë 05.04.2021.

Vlerësimi i Gjykatës

2. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoi provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.
3. Gjykata konstaton se vendimit të Inspektoratit Sanitar është në kundërshtim me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse nr. 07/L-006 (në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar) neni 23 që përcakton *“Masat ndëshkimore të përcaktuara me këtë ligj shqiptohen nga Policia e Kosovës, Inspektorati shëndetësor, inspektorati farmaceutik, inspektorati sanitar dhe inspektoratet komunal”* si dhe në kundërshtim me pikën 12 të Vendimit të Qeverisë 01/07 të datës 18.04.2021 me të cilën pikë *“Kufizohet qarkullimi i qytetarëve nga ora 22:30 deri në ora 05:00...”*
4. Ndërsa e paditura Inspektorati Sanitar bazuar në raportin e inspektimit të realizuar tek paditësi, me datë 25.05.2021, inspektimin e ka realizuar në ora 22:24, me ç’rast Inspektorët kanë konstatuar se stafi ka qenë duke punuar jashtë orarit të lejuar për qarkullim dhe ishte duke shërbyer klientët pas orës 22:00 dhe menaxheri nuk ka qenë i pajisur me leje valide të EDI të sistemit nga ATK. Gjykata vlerëson se në kohën kur është realizuar inspektimi në orën 22:24 tek pala paditëse, nuk ka qenë i kufizuar qarkullimi, prandaj nuk mund të konsiderohet se paditësi ka qenë duke punuar jashtë kufizimit të qarkullimit në kohën e inspektimit. Prandaj, gjoba e shqiptuar nr.017276/IS e datës 25.05.2021, është e kundërligjshme sepse paditësi ka qenë duke operuar në kohën e lejuar, për të cilën nuk ka pasur kufizim.
5. Prandaj, nga provat e administruara u vërtetua se e paditura në Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave AUV.Ref.04/2-519/2021 i datës 07.06.2021, nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe ka marrë vendim në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit nr. 05/L-031 i për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA. Prandaj, gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar duhet të anulohet si i kundërligjshëm.

6. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi lidhur shpenzimet procedurale u vendos në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.622/22, me datë 09.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.